



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# Raport Konsultativ

Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike

**SHTE9 (2015-2016)**

**Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (Viti Relevant 3)**

## DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të pranimit të komenteve potenciale nga palët e interesit. Raporti nuk paraqet Vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

**09 mars 2015**



## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) .....</b>	<b>3</b>
2.1	S-faktori dhe norma e interest për përshtatjet.....	4
2.2	Norma e aplikueshme e inflacionit .....	4
2.3	Përshtatjet e FPEE-së .....	5
2.3.1	Përshtatjet për kosto të pakontrolluara (Sigurimi) .....	5
2.3.2	Taksa e licencës .....	5
2.3.3	Kostot e lejuara të Operimit dhe të Mirëmbajtjes .....	5
2.3.4	Zhvlerësimi i lejuar .....	5
2.4	Kostot e debalancit për FPEE-në .....	5
2.5	Kostot e lejuara të kapitalit punues (WCLCt).....	6
2.6	KREV .....	6
<b>3</b>	<b>Përmbledhje .....</b>	<b>7</b>



## Përmbledhje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është duke e bërë aktualisht Përshtatjen e Rregullt dhe Azhurnimin Vjetor të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Kompanive të Rregulluara në Sektorin e Energjisë Elektrike në kuadër të Shqyrtimit të Nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE9). Si pjesë e këtij procesi, ZRRE do të azhurnojë MAR e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE) dhe do të përshtatë MAR e Gjeneratorit të Rregulluar (KEK), Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) bazuar në shifrat e caktuara në Shqyrtimin Periodik të bërë në kuadër të SHTE7. Ky Raport Konsultativ paraqet vlerësimin e ZRRE-së të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike. Së bashku me këtë raport, ZRRE do të publikojë vlerësimin e tyre të Kostove të Blerjes së Energjisë me Shumicë (WHPC) dhe të MAR të Gjeneratorit të Rregulluar, KOSTT dhe OSSH.

## Komentet e palëve të interesit

ZRRE beson fuqimisht se konsultimi publik qëndron në thelb të politikave efektive rregullative. Me këtë, ZRRE i jep Kompanive të Rregulluara dhe Konsumatorëve mundësinë të shqyrtojnë të dhënat dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë Raport Konsultativ, me të cilat ata mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë ato duke përmirësuar gabime faktike, duke dhënë kundër-argumente apo duke ofruar të dhëna të reja të cilat ZRRE ndoshta ende nuk i ka konsideruar. Palët të cilat dëshirojnë të shprehin mendimin e tyre mbi qëndrimin e ZRRE, ftohen ti dorëzojnë komentet e tyre me shkrim në [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) jo më vonë se **23 mars 2015**. Përndryshe, komentet mund të dërgohen edhe me postë tek:

Zyra e Rregullatorit për Energji  
Departamenti për Tarifa dhe Çmime  
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12  
Prishtinë, 10000, Kosovë

## Dokumente relevante

Vlerësimi final i ZRRE-së të MAR të FPEE në kuadër të SHTE7	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_DSO_PES_22_March_2013.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2013/Proceset%20e%20Shqyrtimit/eng/Evaluation_DSO_PES_22_March_2013.pdf</a>
Raporti Konsultativ i ZRRE-së mbi Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë në kuadër të SHTE8	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2014/FPEE_Kalkulimet_e_te_Hyrave_te_Lejuara_Maksimale_Raporti_Perfundimtar_SHTE8_final.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2014/FPEE_Kalkulimet_e_te_Hyrave_te_Lejuara_Maksimale_Raporti_Perfundimtar_SHTE8_final.pdf</a>
Raporti Konsultativ i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm nga ZRRE	<a href="http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf">http://ero-ks.org/Tarifat/2014/Raport_vleresues_shqyrtimi_i_jashtzakonshem_10_8_2014.pdf</a>
Aplikacioni i KEDS-FPEE i dorëzuar në kuadër të procesit të Përshtatjes së tretë të Rregullt (SHTE9)	
Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së)	<a href="http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/PES_Pricing_Rule.pdf">http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/English/PES_Pricing_Rule.pdf</a>



## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është duke e bërë aktualisht Shqyrtimin e nëntë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike përmes Përshtatjeve të Rregullta për Vitin Relevant Tarifor në kuadër të Shqyrtimit Shumëvjeçar (periodik) të Tarifave për Gjeneratorin e Rregulluar, Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FPEE-së janë të caktuara për një periudhë një vjeçare, por Vlerat Hyrëse, të cilat përdoren në llogaritjen e MAR të FPEE-së, caktohen gjatë Shqyrtimeve të Vlerave Hyrëse – siç është Shqyrtimi Periodik në kuadër në SHTE7 – dhe janë fikse për një periudhë të gjatë kohore. MAR e FPEE-së rishqyrtohet gjatë secilit Azhurnim Vjetor për t'i korrigjuar ndryshimet në mes të faturimit të parashikuar dhe të realizuar, dhe në nën- apo mbi-kompensimin e MAR për shkak të ndryshimeve në mes të kostove të blerjes së energjisë me shumicë të parashikuara dhe të realizuara, si dhe në mes të kostove të bartshme të parashikuara dhe të realizuara, të cilat i nënshtrohen çfarëdo ndarjes të kostove të debalancit dhe të hyrave të eksportit në mes të FPEE-së dhe konsumatorëve të rregulluar.

Gjatë këtij procesit të Azhurnimit Vjetor, ZRRE nuk do t'i rishikojë vlerat hyrëse të cilat ishin caktuar gjatë shqyrtimit të fundit të Vlerave Hyrëse. Në vend të kësaj, ZRRE do të:

1. Llogarisë Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë, të cilat përfshijnë koston e blerjes së energjisë nga Gjeneratorët e Rregulluar, Importet dhe Marzhën me Pakicë. Këto azhurnohen që të reflektojnë ndryshimin në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara të blerjes së energjisë në Periudhën paraprake Rregullative;
2. Llogarisë Kostot e Lejuara me Pakicë të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike, të cilat përfshijnë kosto të operimit dhe të mirëmbajtjes së aktivitetit të FPEE-së, kostove të korporatës, lejimet e zhvlerësimit dhe kosto të tjera të arsyeshme të FPEE-së.
3. Caktojë MAR e ri të FPEE-së duke përfshirë ndryshimin në mes të faturimit të lejuar dhe të realizuar në Periudhën paraprake Rregullative;
4. Caktojë Tarifat e reja me Pakicë;

## 2 Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE)

Rregulla e Çmimeve konstaton së MAR e FPEE-së caktohet në një proces të tri fazave të ndryshme:

- **Faza I:** Përcaktimi i kostove të importit. Gjatë kësaj faze, FPEE i dorëzon Rregullatorit propozimin e tyre të kostove të importit të nevojshme për të mbuluar kërkesën e energjisë së paku 80 ditë para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant. Në të njëjtën kohë, Gjeneratori i Rregulluar i dorëzon FPEE-së aplikacionin e tyre për Përshtatjen e Rregullt të MAR të Gjeneratorit të Rregulluar për Vitin Relevant Tarifor.
- **Faza II:** Përcaktimi i kostove me pakicë. Gjatë kësaj faze, FPEE i dorëzon Rregullatorit propozimin e tyre të Kostove me Pakicë që duhet të rikthehen brenda vitit të ardhshëm. Kjo



përfshin kostot e lejuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes, kostot e lejuara të korporatës, zhvlerësimin e lejuar dhe kosto të tjera të cilat realizohen në mënyrë të arsyeshme nga FPEE gjatë ofrimit të shërbimeve me pakicë Konsumatorëve të Rregulluar.;

- **Faza III:** Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale dhe të Tarifave të Rregulluara. Gjatë kësaj faze, FPEE i dorëzon ZRRE-së propozimin e tyre për MAR të FPEE-së për Vitin e ardhshëm Relevant.

## 2.1 Përshtatjet për S-faktorin dhe normën e interesit

Sipas Shtojcës 1 të Artikullit 2.1 të Rregullës për Çmime të FPEE, norma e interesit e aplikueshme në MAR të FPEE në cilin do Vit Relevant është e llogaritur duke u bazuar në EURIBOR plus S%, ku S është vlerë e përcaktuar nga rregullatori gjatë Azhurnimeve Vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për kreditë afatshkurtra. Kjo ndryshon nga principi i aplikuar në Rregullat e tjera të Çmimeve ku vlera S caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe mbahet konstante përgjatë Periudhës Rregullative.

ZRRE ka ricaktuar vlerën S për përshtatjet e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike si në vijim:

Normat e interesit të kredive në Kosovë janë marrë nga Buletini Mujor Statistikor i Bankës Qendrore të Kosovës, Tabela 14.2 (Normat efektive të interesit të KTD-ve – normat në kredi)<sup>1</sup>. Vlera e marrë është për norma të kredive afariste investuese për kredi me maturitet deri në 1 vit. Kjo vlerë, për janar 2014, është 13.08%.

Norma finale e interesit për përshtatje është vlera për dhjetor 2014 (10.8%) minus EURIBOR për dhjetor 2014 (0.330%<sup>2</sup> – EURIBOR 1-vjeçar për dhjetor 2014) + 0.252% (norma aktuale e EURIBOR<sup>3</sup>) = 10.72%.

## 2.2 Norma e aplikueshme e inflacionit

Siç është e kërkuar nga Rregullat për Çmime, ZRRE ka përdorur Indeksin e Harmonizuar të çmimeve të konsumatorëve (HICP) për të gjitha njësitë në Eurozonë për të llogaritur normën e aplikueshme vjetore për FPEE-në. Norma rezultuese e inflacion del të jetë 0.43%<sup>4</sup> sipas Eruostatit.

---

<sup>1</sup><http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-BMS%20nr%20160.pdf>

<sup>2</sup><http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>

<sup>3</sup>Norma Euribor për 19 shkurt 2015 (<http://www.euribor-rates.eu/euribor-rate-12-months.asp>)

<sup>4</sup>[http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=prc\\_hicp\\_manr&lang=en](http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=prc_hicp_manr&lang=en)



## **2.3 Përshtatjet e FPEE-së**

### **2.3.1 Përshtatjet për kosto të pakontrolluara (Sigurimi)**

KEDS kanë kërkuar një lejim prej € 0.16 milion për t'i mbuluar kostot e sigurimit të punonjësve të tyre me një kosto mujore prej €13.92 për punonjës. KEDS thotë se kontrata ishte nënshkruar para marrjes së KEDS nga investitori privat (Kosovo Calik – Limak Energy).

ZRRE ka përshtatur MAR e FPEE-së për t'i përfshirë kostot e sigurimit.

### **2.3.2 Taksa e licencës**

KEDS ka kërkuar një përshtatje për të kompensuar ndryshimin në taksat e licencës të pagueshme për vëllimin e importeve të blera në kuadër të SHTE8 (kostoja e parashikuar e lejuar nga ZRRE ishte €0.1 milion, ndërsa kostot e realizuara nga KEDS ishin €0.094 milion. Ndryshimi është kompensuar me interes.

### **2.3.3 Kostot e lejuara të Operimit dhe të Mirëmbajtjes**

Kostot e lejuara të Operimit dhe të Mirëmbajtjes janë azhurnuar që të reflektojnë marrëveshjen e transferit të personelit OSSH-FPEE me të cilën një numër i konsiderueshëm i personelit ka lëvizur nga FPEE në OSSH. Kjo kishte rezultuar në zbritje të kostove të O&M prej €7.6 milion nga FPEE dhe në shtim të vlerës së njëjtë OSSH-së me zero ndikim neto në tarifa.

OPMct e lejuar gjithashtu është azhurnuar për të reflektuar lejimin për sigurim shëndetësor, siç është në kuadër të SHTE8 dhe për të kompensuar për ndryshimet në mes të ngarkesave të parashikuara dhe të realizuara të alokimit të Administratës Qendrore . Prandaj Lejimi përfundimtar i OPMct të FPEE-së është €6.7million.

### **2.3.4 Zhvlerësimi i lejuar**

Zhvlerësimi i lejuar është caktuar për Vitin e tret Relevant është bazuar në shqyrtimin e bërë nga ZRRE të planit të shpenzimeve kapitale të FPEE-së për pesë vitet e ardhshme. Lejimi i zhvlerësimi për Vitin e dytë Relevant ishte llogaritur të jetë €0.3 milion. Zhvlerësimi i lejuar i FPEE-së do të përfshijë një përshtatje vjetore të inflacionit prej 0.43% mbi lejimin paraprak për zhvlerësim. Prandaj, vlera përfundimtare e zhvlerësimi të lejuar të FPEE do të jetë €0.3 milion.

## **2.4 Kostot e debalancit për FPEE-në**

Gjatë vitit 2015, KOSTT do të prezantojë një mekanizëm balancues. Në kuadër të kësaj, gjeneratorët dhe furnizuesit të cilët janë në debalanc (oferta apo kërkesa reale nuk përkojnë me vëllimet e nominuara) do të duhet t'i paguajnë kostot e marra përsipër nga KOSTT gjatë kompensimit për këtë.

Në Rregullën për Çmime të FPEE, ZRRE lejon që FPEE t'i mbulojë kostot e realizuara në vitin paraprak të zgjidhjes të ndonjë debalanci të tillë, duke iu nënshtruar faktorit ndarës të debalancit. Kur ky faktor është më pak se 100%, do të thotë se FPEE nuk mund t'i mbulojë në tërësi kostot e tyre të debalancit për t'i dhënë nxitje që t'i minimizoj ato (dmth. duke minimizuar debalancin).

Gjatë vitit 2015, ZRRE do të monitorojë saktësinë e parashikimeve të kërkesës së FPEE dhe nominimet rezultuese të kërkesës. Aty ku këto janë vazhdimisht të pasakta në shumën të



konsiderueshme, duke e detyruar KOSTT që të marrë masa për të balancuar ofertën dhe kërkesën reale, ZRRE do të konsiderojë caktimin e një faktori ndarës prej më pak se 100% në 2016 (që do të aplikohet në mbulimin e kostove të debalancit të FPEE-së të realizuara në 2015). Kjo është për të dhënë nxitje për FPEE-në që të parashikojë me saktësi kërkesën pasi që mekanizmi balancues të ketë filluar operimin.

## 2.5 Kostot e lejuara të kapitalit punues (WCLCt)

Neni 11 i Rregullës për Çmime të FPEE përcakton se Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike duhet të i lejohet t'i mbulojë kostot e kapitalit punues. Kostot e kapitalit punues do të llogariten duke përdorur koston e financimit të këtij kapitali (EURIBOR + 5%) plus shuma e kostove të lejuara me pakicë, kostot e lejuara të energjisë me shumicë, kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë dhe kostot e bartshme. Formula për llogaritjen e lejimit të WCLC është e dhënë në paragrafin 2.1 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmime të FPEE:

$$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

*Ku*

*I<sub>t</sub>* është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra

*RETR<sub>t</sub>* janë kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t

*WHPC<sub>t</sub>* janë kostot e energjisë së përgjithshme me shumicë në vitin relevant t

*PSTC<sub>t</sub>* janë kostot e bartshme në vitin relevant t

*NTFR<sub>t</sub>* janë të hyrat jotarifore në vitin relevant t

WCLC rezultuese përfundimtarë për t'u mbuluar nga FPEE është €1.9 milion.

## 2.6 Përshtatja e humbjeve për SHTE8

Sipas Rregullës për Vënien e çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (Rregullën e çmimeve të FPEE), Zyra e Rregullatorit për Energji duhet të zbresë të hyrat e FPEE-së nga shitja e humbjeve ndaj OSSH-së dhe OST-së në mënyrë që të shmanget mbulimi i dyfishtë i kostove të humbjeve.

Rregullat e çmimeve janë caktuar ashtu që të funksionojnë si në vijim (I njëjti parim vlen si për OST ashtu edhe për OSSH):

- Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike paguan koston e lejuar të blerjes së energjisë me shumicë të cilën e mbulon nga të hyrat e mbledhura nga tarifat me pakicë;
- MAR i OSSH-së caktohet në atë mënyrë që t'i lejohet OSSH-së të mbulojë të hyra të mjaftueshme për të kompensuar FPEE-në për nivelin e lejuar të humbjeve;



- Nëse OSSH nuk e mbulon cakun e humbjeve dhe, rrjedhimisht, FPEE duhet të blejë më tepër energji për të shtyrë në rrjet me qëllim të mbulimit të ngarkesës së konsumatorëve fundorë, atëherë OSSH është e obliguar të paguajë FPEE-në për vlerën shtesë të energjisë (për shkak të humbjeve më të mëdha të energjisë në krahasim me ato të lejuara nga ZRRE, duke pësuar humbje). Kjo “pagesë” bëhet duke zbritur MAR-in e OSSH-së në mënyrë që të zvogëlohen pagesat e FPEE-së ndaj OSSH-së vitin tjetër;
- Gjatë llogaritjes së MAR-it të FPEE-së, të hyrat e pritshme nga shitja e humbjeve zbriten për të shmangur mbulimin e dyfishtë të kostove të humbjeve. Mirëpo vlera e zbritur e humbjeve duhet të jetë e barabartë me të hyrat totale të pritura nga humbjet për Vitin Relevant ( $LSSAt \times REUEt \times WHEAt$ ) dhe jo vlera finale e humbjeve që, sipas Paragrafit 2.4 të shtojcës 1 të Rregullës, merr parasysh edhe përshtatjet në mes të kostos së lejuar dhe të realizuar të vitit paraprak. Zbritja e humbjeve totale pas përshtatjeve (LSSCt) nga MAR i FPEE-së, si në SHTE8, do të kthente çdo përfitim të reduktimit të humbjeve drejt FPEE-së.

MAR-i i FPEE-së është reduktuar për të reflektuar faktin se humbjet duhet të zbriten para përshtatjeve dhe jo pas përshtatjeve, siç është sqaruar më lart. Argumenti vlen si për OSSH-në ashtu edhe për OST-në.

## 2.7 Faktori i përshtatjes së të hyrave (KREV)

Një nga elementët kyç që e ndikojnë MAR të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (por edhe atë të OSSH dhe KOSTT) është ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) dhe të Hyrave të Rregulluara të Realizuara (ARR). Ky ndryshim mbulohet duke përdorur formulën e KREV, siç është e definuar në Artikullin 5, paragrafin 3.2 dhe Shtojcën 1, paragrafin 2.4 të Rregullës për Çmime të FPEE.

Llogaritja rezultuese e KREV në kuadër të SHTE8, pas interesit, është €33.7milion.

## 3 Përmbledhje

Vlera përfundimtare e MAR për sektorin e energjisë elektrike për Vitin e Relevant tarifor është €256.7 milion.

Kostot e lejuara me Pakicë (Neni 10 i Rregullës për Çmime të FPEE) janë vlerësuar të jenë €6.7 milion. Ky lejm ka përfshirë një përshtatje për sigurim shëndetësor, rialokim të Zyrës Qendrore dhe kosto të taksës së licencës. Kostot e bartshme të lejuara (PSTCt) për pagesa OSSH-së dhe OST-së janë €93.6milion. Të hyrat e lejuara nga shitjet e humbjeve tek OST dhe OSSH janë €30.8 milion. Kostot e kapitalit punues janë €1.9 milion. Kostot totale të Blerjes së Energjisë me Shumicë janë €149.6 milion. Borxhet e këqija të lejuara janë €13.2 milion.





MAR është i përmbledhur në Tabelën 6.

**Tabela 1 Kostot e lejuara me pakicë, kostot e bartshme dhe të hyrat e FPEE-së nga shitjet**

FPEE MAR		SHTE8 Lejuar	SHTE8 Jashtëzak.	SHTE9 Propozuar
<b>Parametrat e Indeksimit</b>				
Faktori i efikasitetit	%	0.00%	0.00%	0.00%
Faktori profilizues		0.00	0.00	0.00
HICP	%	0.70%	0.70%	0.43%
Euribor	%	0.60%	0.60%	0.25%
S-faktori	%	12.54%	12.54%	10.47%
It	%	13.14%	13.14%	10.72%
<b>Kostot e lejuara me pakicë (RETRt - Neni 10 Rregulla për Çmime të FPEE)</b>				
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	12.4	12.4	6.7
OPEX i përshtatur, pa Zyrën Qendrore	€m			10.7
$DEPCt = DEPCt-1 * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - Pt)$	€m	0.20	0.2	0.3
Kostot e Sigurimit shëndetësor	€m	0.2	0.2	0.0
Rialokimit i kostove të Administratës Qendrore	€m	1.3	1.3	2.9
Taksa e licencës	€m	0.1	0.1	0.11
Transferi i personelit OSSH-FPEE	€m	0.0	0.0	-7.6
Ngarkesa ndër-kompani	€m			0.3
<b>Kostot e bartshme (PSTCt)</b>				
Ngarkesat e KOSTT	€m	17.8	18.0	22.8
Ngarkesat e OSSH	€m	63.9	66.4	70.7
			81.7	93.6
<b>Të hyrat nga shitjet e humbjeve tek OST dhe OSSH</b>				
Të hyrat OST	€m	3.3	3.5	3.1
Të hyrat OSSH	€m	23.8	26.3	27.6
			27.1	
<b>Kostot e kapitalit punues (WCLCt)</b>				
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	2.2	2.3	1.9
<b>Kostot e blerjes së energjisë me shumicë (WHPC)</b>				
WHPC	€m	142.3	154.0	149.6
Marzha me pakicë	€m			



Përshtatja e marzhës me pakicë

€m 

0.0	0.0	
-----	-----	--

### Të hyrat jo-tarifore (NTFR)

Të hyrat jo-tarifore (NTFRt)

€m 

--	--	--

### Lejesat e borxhit të keq (BDTA)

BDTA

% 

5%	5%	5%
----	----	----

BDTA

€m 

12.0	12.6	13.2
------	------	------

BDTA Përshtatja

€m 

0.3	0.3	
-----	-----	--

### KREVt

FPEE KREVt

€m 

12.3		
15.4	15.4	33.7

OSSH KREVt

€m 

3.0	3.0	3.1
-----	-----	-----

KOSTT KREVt

€m 

-0.2	-0.2	1.5
------	------	-----

### Përshtatjet e tjera

Përshtatje e kostove të pakontrolluara (Sigurimi)

€m 

0.2	0.2	
-----	-----	--

Përshtatje e kostove të pakontrolluara (Rialokimi i ZQ)

€m 

1.3	1.3	
-----	-----	--

Taksa e licencës (Importet)

€m 

0.0	0.0	
-----	-----	--

Përshtatje e humbjeve SHTE8 OSSH

€m 

		-6.1
--	--	------

Përshtatje e humbjeve SHTE8 OST

€m 

		0.3
--	--	-----

### FPEE MAR

FPEE MAR

€m 

240.0	252.4	256.7
-------	-------	-------